VENDIM
Nr. 163, datë 17.12.2012

MBI ANKANDIN VJETOR DHE MUJOR TË KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT TË VITIT 2013

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "ç" paragrafi "ii" dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, pikës 7 germa "b" të modelit të tregut të energjisë elektrike të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe kapitullit X pika 2 të "Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike", të miratuara nga ERE me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 17.12.2012, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut,

VENDOSI:

1. OST sh.a. të shtyjë zhvillimin e ankandit vjetor për kapacitetet ndërkufitare deri në datën 22.1.2013.

2. OST sh.a. të alokojë me të drejta të siguruara pa pagesë kapacitetet ndërkufitare të interkonjeksionit për muajin janar 2013, në drejtim importi, për kryerjen e importit të energjisë elektrike për furnizimin e konsumatorëve tariforë dhe mbulimin e humbjeve në sistem.

3. OST sh.a. të zhvillojë ankand për muajin janar 2013 për kapacitetet e mbetura ndërkufitare, në drejtimin e importit, pas plotësimit të pikës 2 të këtij vendimi.

4. OST sh.a. të zhvillojë ankandin për muajin janar 2013 për kapacitetet ndërkufitare në drejtim eksporti.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani